

# Ligjvënësit evropianë doemos duhet ta mbyllin vrimën e rrezikshme në Ligjin për IA

**Bashkimi Evropian hyn në fazën e fundit të negociatave për Ligjin për inteligjencë artificiale (Ligji për IA), por firmat e mëdha teknologjike dhe aktorët tjerë të industrisë llobojnë që të hapet vrimë shumë e madhe në procesin e klasifikimit të rreziqeve të larta, gjë që do të shpjerë në minimin e gjithë legjislacionit. I ftojmë ligjvënësit e BE-së që ta largojnë këtë vrimë në Ligjin dhe të mundësojnë nivel të lartë të mbrojtjes në Ligjin për IA.**

Ligji për IA i BE-së ka potencial për ta përmirësuar mbrojtjen e njerëzve që janë të rrezikuar nga sistemet për IA. Në versionin burimor të Ligjit është cekur lista e “përdorimeve të IA me rrezik të lartë”, përfshirë edhe sistemet me IA për monitorimin e nxënësve, vlerësimin e aftësisë kreditore të konsumatorëve, vlerësimin e punëkërkuësve dhe identifikimin e personave që marrin ndihmë sociale.

Ligji imponon që personat që planifikojnë dhe përdorin IA me “rrezik aq të lartë” të kujdesen që sistemet e tyre të jenë të sigurt, të mos jenë përplot me paragjykime në bazë diskriminuese dhe të shpërndajnë publikisht informacione lidhur me punën e sistemeve të tyre. Megjithatë, ato përfitime minohen falë një vrimë të rrezikshme në Ligjin që hapet në procesin e klasifikimit të rreziqeve të larta në nenin 6.

Në versionin burimor të Komisionit Evropian, një sistem për IA konsiderohet se është me “rrezik të lartë” nëse përdoret për ndonjë prej qëllimeve me rrezik të lartë të cekura në Aneksin III. Megjithatë, Këshilli dhe Parlamenti Evropian hapën vrimë në ligjin që do t’u mundësojë personave që i hartojnë këto sisteme të vendosin vetë nëse konsiderojnë se sistemi është me “rrezik të lartë”<sup>1</sup>. Kompania e njëjtë që përfshihet me ligjin do të ketë mundësi që të vendosë vetë nëse ai Ligj ka të bëjë me të ose jo.

**Këto ndryshime të nenit 6 doemos duhet të refuzohen dhe doemos duhet të vendoset procesi fillestar i klasifikimit të rreziqeve të Komisionit Evropian. Doemos duhet të ekzistojë një proces objektiv, konsekuent dhe i sigurt juridikisht që të përcaktohet se cilat sisteme me IA janë me “rrezik të lartë” në Ligjin për IA.**

Nëse ndryshimet e nenit 6 nuk anulohen, Ligji për IA personave që i hartojnë sistemet do t’u mundësojë të vendosin të përjashtohen nga të gjitha rregullat thelbësore për sistemet me rrezik të lartë. Ligji për IA:

- **do të shkaktojë pasiguri të madhe juridike** lidhur me atë se cilat sisteme konsiderohen sisteme me “rrezik të lartë”;
- **do të shkaktojë copëtimin e Tregut të vetëm të BE-së** dhe interpretime të ndryshme për atë se çfarë nënkuptohet me “rrezik të lartë” në mbarë vendet anëtare;
- do të shkaktojë **probleme serioze gjatë zbatimit të Ligjit të autoritetet e vendeve anëtare**, me resurse të pamjaftueshme për monitorim të kënaqshëm të vetëvlerësimit të personave që i hartojnë sistemet;
- **personave të pamoralshëm që i hartojnë sistemet do t’u mundësojë t’i shmangin**

**kërkesat themelore të Ligjit** gjë që i bëjnë sistemet e tyre më të sigurt dhe më të besueshëm. Kjo do t'i lë personat e përgjegjshëm që i hartojnë sistemet në gjendje të palakmueshme.

**Kërkojmë nga ligjvënësit që t'i anulojnë këto ndryshime dhe ta kthejnë tekstin burimor të Komisionit në nenin 6.** Ligji për IA doemos duhet t'i prioritizojë të drejtat e personave të cilët janë të rrezikuar nga sistemi me IA dhe të mundësojë hartim dhe përdorim të përgjegjshëm dhe transparent të IA.<sup>ii</sup>

Nënshkrues,

1. Access Now
2. BEUC – The European Consumer Organisation
3. European Digital Rights (EDRi)
4. Access Info Europe
5. AlgoRace
6. Algorights
7. AlgorithmWatch
8. All Faiths and None
9. All Out
10. Alternativ Bilisim (AiA-Alternative Informatics Association)
11. Amnesty International
12. ARSIS Association for the Social Support of Youth
13. Article 19
14. Asia Indigenous Peoples Pact
15. Aspiration
16. Association for Legal Studies on Immigration (ASGI)
17. Association Konekt
18. Balkan Civil Society Development Network
19. Bits of Freedom
20. Bulgarian center for Not-for-Profit Law (BCNL)
21. Center for AI and Digital Policy (CAIDP)
22. Chaos Computer Club
23. Civil Rights Defenders
24. CIVIL SOCIETY ADVOCATES
25. CNVOS Slovenia
26. Coalizione Italiana Libertà e i Diritti civili
27. Comisión General Justicia y Paz de España
28. Controle Alt Delete
29. Corporate Europe Observatory (CEO)
30. D64 - Zentrum für Digitalen Fortschritt e. V.
31. DanChurchAid (DCA)
32. Danes je nov dan, Inštitut za druga vprašanja
33. Defend Democracy
34. Democracy Development Foundation Armenia
35. Digitalcourage
36. Digital Security Lab Ukraine
37. Digitale Gesellschaft
38. Digitalfems
39. DonesTech
40. dTest, o.p.s.
41. Eticas
42. EuroMed Rights

43. European Anti-Poverty Network (EAPN)
44. European Center for Not-for-Profit Law
45. European Civic Forum
46. European Movement Italy
47. European Network Against Racism (ENAR)
48. European Network on Statelessness
49. Fair Trials
50. Fair Vote UK
51. Fundación CIVES
52. Federación de Consumidores y Usuarios CECU
53. Federación de Sindicatos de Periodistas (FeSP)
54. Federation of German Consumer Organisations (Verbraucherzentrale Bundesverband – vzbv)
55. FIPR
56. Fritidsodlingens Riksorganisation
57. Gong
58. Greek Forum of Refugees
59. Health Action International
60. Homo Digitalis
61. Hungarian Civil Liberties Union
62. I Have Rights
63. IDAY Liberia Coalition Inc.
64. Institute Circle
65. Institute for Strategic Dialogue (ISD)
66. Irish Council for Civil Liberties
67. IT-Pol
68. Iuridicum Remedium
69. KEPKA- Consumers Protection Center
70. Kif Kif vzw
71. KOK German NGO Network against Trafficking in Human Beings
72. Konsumentvägladarnas Förening
73. Kosovar Civil Society Foundation (KCSF)
74. LA LIGUE DE L'ENSEIGNEMENT
75. La Strada International
76. Lafede.cat
77. LDH (Ligue des droits de l'Homme)
78. Legal Centre Lesvos
79. Liberty
80. Ligue des droits humains
81. Metamorphosis Foundation
82. Migrant Tales
83. Mobile Info Team
84. Moje Państwo Foundation
85. National Federation of Polish NGOs (OFOP)
86. National NGO Coalition
87. New Europeans International
88. Norwegian Consumer Council
89. Novact
90. OCU (ORGANIZACIÓN DE CONSUMIDORES Y USUARIOS)
91. Ökotárs - Hungarian Environmental Partnership Foundation
92. Open Knowledge Foundation Germany
93. Panoptykon Foundation

94. Partners Albania for Change and Development
95. PIC - Legal Center for the Protection of Human Rights and the Environment
96. Platform for International Cooperation on Undocumented Migrants (PICUM)
97. Polish Women's Strike Foundation
98. Politiscope
99. Privacy First
100. Privacy International
101. Privacy Network
102. PRO, Pensionärernas riksorganisation
103. Promo-LEX Association
104. Prostitution Information Center
105. Protection International
106. Red en Defensa de los Derechos Digitales
107. REPONGAC
108. SKPF Pensionärerna
109. SOLIDAR & SOLIDAR Foundation
110. Spiralis
111. Statewatch
112. Stichting LOS
113. Superbloom (previously known as Simply Secure)
114. Swedish Asthma and Allergy Association
115. SYMBIOSIS
116. Symbiosis - Council of Europe School of Political Studies in Greece
117. The Swedish Consumers' Association
118. Wikimedia Deutschland e. V.

---

<sup>i</sup> Teksti i Këshillit propozon të përjashtohen sistemet me rrezik të lartë kur rezultatet nga sistemi janë "*krejtësisht dytësore ndaj veprimt ose vendimit kryesor që duhet ndërmarë*". Teksti i Parlamentit Evropian thotë se një sistem është me rrezik të lartë vetëm nëse përbën "rrezik të konsiderueshëm" për të drejtat themelore, shëndetin dhe sigurinë. Nëse personi i cili e harton sistemin konsideron se sistemi i tij nuk përbën rrezik të tillë, ai duhet doemos t'i njoftojë autoritetet kombëtare, të cilat kanë 3 muaj në dispozicion për t'u përgjigjur. “.

<sup>ii</sup> 150 organizata civile i ftojnë institucionet e BE-së të përcaktojnë nëse Ligji për IA i mbron të drejtat e njerëzve gjatë dialogjeve për Ligjin për IA: <https://edri.org/wp-content/uploads/2023/07/Civil-society-AI-Act-trilogues-statement.pdf>